



Berisha refuzon presionin e Erdogan, zbardhet telefonata për Palestinën



Gazeta turke "Hurryet" shkruante dje se Berisha ka refuzuar presionin e Kryeministrit turk për çështjen e statusit të Palestinës. Erdogan i ka telefonuar Berishës dhe i kërkuar që Shqipëria të votonte pro statusit të posaçëm të Palestinës, por pa mundur ta bindë. Erdogan: U thashë atyre se kjo do të dëmtonte marrëdhëniet dypalëshe që ne kemi. Madje do të na mërzhiste.

FAQE 2-3

Zhduket djali i punonjësit të SHISH, Babai: Nuk kemi probleme me askënd

10-vjeçari Julian Çela është larguar nga banesa e tij që prej ditës së premte, ndërsa familjarët nuk kanë asnjë informacion për vendndodhjen e tij

FAQE 6



BORXHI 236 MIJË EURO SI U EKZEKUTUAN DY VËLLEZËRIT PËR PARATË E HOTELIT NË DHËRMI

Dinamika e krimit të dyfishtë: Autori qëllon fillimisht Iglendin që ndodhej në ndenjësen e pasme dhe plagosi rëndë Sokol Haxhialiu, i cili ndërroi jetë në spital. Vrasjet pas debatit në makinë për borxhin 200 mijë euro dhe interesat e tij, që vëllezërit kishin marrë për ndërtimin e një hoteli në Dhërm. Policia liron Arian Ndreken, të shoqëruar mbrëmjen e së shtunës: Nuk është i implikuar në ngjarje. Shpallet në kërkim Eduard Kurti, si autor i dyshuar i krimit: U filmua nga kamerat e bankës.

FAQE 7

Iglend Haxhialiu, i vrarë para dy ditësh



Isaraj kundër Finos: Listën nuk e vendos ti, por qytetarët

Deputeti dhe anëtar i kryesisë së PS-së, Arben Isaraj i përgjigjet në Facebook deklaratës së Finos se 80% e deputetëve të PS do të rikandidojnë sërish në 2013. "Dua të them se politika e ka një vend ku vlerësohet-komunitetin arbitër. Qytetari,



Arben Isaraj

mbështetësi, militanti, anëtar i socialist, si komunitet është ai që vlerëson se kush bën e kush nuk bën ndër ne"

Deklarata e deputetit të Partisë Socialiste, Bashkim Fino nuk është pritur mirë nga disa deputetë të familjes së tij politike. Sipas tyre, Fino ka gabuar kur foli për përqindjet e deputetëve që do të jenë sërish në listën...

FAQE 4

OP-ED / 18-19



Pesha e Ramushit

Kthimi i Ramush Haradinajt nga Haga solli një moment të ri në raportet politike në Kosovë...



Dy shtete -një ekonomi

Një shekull shtet - një moment që dëshmoi qartë se banorët e të dyja shteteve, Shqipërisë...

KOMENT
IBRAHIM REXHEPI

NGËRÇ NGA BUJAR KAPEXHIU



Peshë e rëndë

SUPLEMENT

Pastori: Si e solla në anglisht Barletin që 'takova' në rrugë

"Rrethimi i Shkodrës", vepra e parë e letërsisë historiografike shqiptare botohet për herë të parë në gjuhën angleze me përkthimin e David Hosaflook

RECENSA E PREÇ ZOGAJ

Teoria që sheh bardhë dhe lart

"Protonizmi: Nga teoria në praktikë", vizione letrare nga Dr. Gjerkë Marinaj, botuar nga Shtëpia botuese "Nacional"

FAQE 13-18



KOMENT / 11

RUDINA XHUNGA



100 vjet të tjera

Shteti shqiptar ka hyrë në shekullin e dytë të jetës së tij, dhe kjo në jetën e një shteti nuk është shumë, por jo dhe pak. Ka në botë të tillë me disa shekuj në biografinë e tyre, si dhe të tjerë me disa vjet. Ajo që e dallon një shtet më shumë se moshë, është serioziteti i shtetasve në sjelljen ndaj tij. Dhe si shteti sillet ndaj fëmijëve të shquar. Ne si shqiptarë, si shtet kemi merita, siç kemi dhe gabime. Shteti shqiptar, erdhi në jetë mes gjakut të shqiptarëve këndej dhe andej kufirit. Nuk do kishim këtë shtet, pa ndihmën e Kosovës. U desh sakrifikimi i tyre, që të merrte jetë kjo që njohim sot. Kur ministri i Jashtëm anglez, Eduard Grej, i mahnitur nga Isa Boletini, e pyeti se nga ishte dhe i shprehu keqardhjen që nuk mund ta përfshinte Mitrovicën në shtetin që po formësohej pasi ishte larg, mburoja e shtetit...

5

Malaj: Buxheti 2013, barra e borxheve, më e rënda

POLITIKË

Ish-ministri i Financave analizon projekt-buxhetin e qeverisë për vitin e ri. Arsimi e Shëndetësia, jo prioritete në 2013-ën

A jeni gati për Internet pa Limit me 100Mbps shpejtësi reale?

ABCom juo garanton falë sistemit DOCSIS 3.0 Video-konferencë, File transferring, TV streaming në HD.

Telefono: + 355 4 4500 139

www.abcom.al



RECENSA

“Protonizmi: Nga teoria në praktikë”, vizione letrare nga Dr. Gjekë Marinaj, botuar nga Shtëpia botuese “Nacional”

Teoria që sheh bardhë dhe lart

Preç Zogaj

Në dëshmitë dhe anekdotat e shumta për poetin e madh anglez të shekullit të nëntëmbëdhjetë, Xhorxh Bajron, është edhe kjo: Bajroni i dërgon në dorëshkrim poemën “Don Zhuan” një mikut të tij të ngushtë, duke i kërkuar një opinion përpara botimit. Pas pak kohësh merr këtë përgjigje: ‘Gjysma e veprës është e mrekullueshme, por gjysma tjetër është si të mos e ketë shkruar e njëjta dorë gjeniu’. - Pse nuk thoni se paskam shkruar një kryevepër, - ia kthen Bajroni jo pa humor. Ku keni parë ju një vepër që të jetë e gjitha, nga fillimi në fund, një mrekulli...

Duam të besojmë se miku i Bajronit kishte shijen e duhur për të dekretuar gjysmën e mrekullueshme të poemës në raport me gjysmën tjetër më pak të mrekullueshme. Thelbësore në këtë anekdotë është se vetë Bajroni na orienton me humorin dhe spontanitetin e tij prej poeti të madh drejt një aksiologjie të pozitives, të së arrirës që është edhe manifestimi i dhuntisë. “Admiro, admiro, se admirimi të rrit”, ka shkruar poeti grek Pallamas. Në veprën e tij të shkëlqyer “Bethoveni dhe revolucioni francez”, Fan Noli, poeti, përkthyesi dhe eseisti ynë poliedrik, konkludon ndër të tjera se kuotat e gjenialitetit artistik, si pasuri e njerëzimit mbarë, janë çaste, shkrepje. Kur e pyetën Jorge Luis Borges-in se cilët ishin poetët që e kishin ndikuar me shumë në jetën e tij, ai u përgjigj me një listë shumë të gjatë, gjë që nuk ishte në zakonet e të mëdhenjve. Të gjithë ata që kishte lexuar kishin lënë gjurmë në formimin e Borhes-it. Arshi Pipa, shkrimtari dhe studiuesi shqiptar që kaloi një pjesë të jetës si i arratisur politik në SHBA derisa ndërroi jetë atje, ishte një intelektual me bindje antikomuniste, por optika politike nuk e pengoi të dallonte dhe të nxirrte në pah vlerat më të mira artistike të disa veprave të shkruara dhe të botuara në Tiranë gjatë regjimit të Enver Hoxhës.

Këto janë vetëm disa referime të evokuara me nxitim nga moria e referimeve që na flasin për një orientim dhe përqendrim të njohjes dhe kënaqësisë drejt së arrirës, apo për një kulturë perceptimi dhe përjetimi të së mirës në letërsi, duke e shkëputur atë nga kontekstet doktrinale të rrymave letrare, si dhe nga tërësia e lëndës së një vepre të caktuar. Pra duke e parë vlerën si një njësi thelbësishat kultivative.

Nga gjithë kjo optikë dhe përvojë e pasur me shembuj të pambarimtë, poeti dhe studiuesi ynë i mirënjohur, Gjekë Marinaj, i lauruar Doktor në Filozofi (PhD) në Universitetin e Dallasit në SHBA, ka përfutur e përpunuar një mënyrë të re të vështrimit dhe shqyrtimit të veprave letrare, të cilën ua ka propozuar arteve dhe shkencave humane në formën e një teorie të re të quajtur Protonizëm.

Njerëzit e lexim-shkrimit në Shqipëri kanë rastin të njihen me parimet bazë të kësaj teorie dhe me aplikime të saj nga vetë Dr. Gjekë Marinaj nëpërmjet librit të tij “Protonizmi: Nga teoria në praktikë”, botuar në shqip nga Shtëpia botuese “Nacional”. Qysh në hyrje të librit, Marinaj sqaron se si perceptim gjuhësor dhe si përshtatje terminologjike Protonizmi është bazuar në fjalën “proton”,

një term nga Fizika dhe Kimia, që si pjesë përbërëse e bërthamës së atomit ka ngarkesë pozitive. Protonizmi pagëzohet kështu si një teori e pozitives, që u jepet njerëzve të letërsisë dhe arteve, autorëve dhe kritikëve, libërdashësve dhe artdashësve si një burim i përqendruar drite që bie dhe ndriçon arin e fshehur brenda dheut dhe mineraleve, perlat e fshehura në guaska, nektarin e natyrës që bletët e mbledhin për ta shndërruar në mjaltë. Nuk është pra një invencion, por është, si me thënë, mbledhja, përpunimi dhe disiplinimi në formën e një teorie letrare të mirëfilltë i një pasurie të natyrës njerëzore që lidhet me mirësinë, me dashamirësinë, me dhuntinë për të admiruar, me frymëzimin e dashurisë dhe jo të vërit kur ulemi për të shkruar për një libër, për një pjesë teatrale, për një pikturë apo simfoni.

Ndërsa po shkruaj këto radhë me vjen në mendje një mendim: njeriu manifeston vetveten në zbulimin e teorive të reja; zbulon vetveten në zbulimin e tyre. Gjithë jeta e Gjekë Marinajt, jeta si njeri, si poet, si përkthyes, si botues, si kritik dhe si studiues i letërsisë ka qenë dhe është “protoniste” - fjala që emërton teorinë e tij na ndihmon të jemi kaq lakonikë në përcaktimin e natyrës së tij. Kjo hollësi vlen për të pohuar përputhjen e subjektit zbulues me zbuluesin. Por ndërkaj, lexuesit e interesuar nuk duhet të iludohen sikur teoria e Protonizmit është thjesht figura e skanerit shpirtëror të autorit. Teoria në fjalë zhvillohet nga dikush që ka përgatitjen e nevojshme filologjike dhe filozofike për të pretenduar prezantimin e një teorie të re në katedrat dhe aulat më të larta të fushës. Kjo duket qartë në formulimin që Dr. Marinaj u ka bërë parimeve bazë të teorisë së tij, që janë pesë.

Parimi i parë është **e vërteta**. Në kundërshtim me filozofinë objektiviste, Protonizmi pohon se nuk ekziston një e vërtetë e shkëputur nga mendja njerëzore.

Parimi i dytë është **kërkimi**. Protonizmi këmbëngul se pavarësisht sa objektivë janë kritikët, njohuritë kontekstuale që ata zotërojnë, ndikojnë në vlerësimet e tyre për veprat.

Doktrina protoniste këshillon të gjithë kritikët të menaxhojnë ose të mbikëqyrin kërkimet e tyre në lidhje me kushtet aktuale dhe nevojat letrare, thelbësisht të komunitetit.

Parimi i tretë është **kthimi** në kuptimin e shpërblimit. Protonizmi kërkon që kritikët letrarë të gjejnë mënyrat e duhura për të reflektuar qëllimet pozitive të autorëve, duke ruajtur sigurisht një standard profesionalizmi. Kjo do të thotë t'i qasesh punës ose veprës me një dëshirë të mirë dhe besim. Nëse kritiku protonist nuk gjen asgjë pozitive apo me vlerë në një vepër, atëherë ai e konsideron atë të barabartë me zero, diçka neutrale. Nëse ai nuk ka asgjë pozitive për të shprehur, atëherë ai nuk thotë asgjë.

Parimi i katërt është **protosemiotika**, një kombinim i Protonizmit me Semiotikën. Protonisti e përdor këtë parim si një mjet zbulues për të përcaktuar nëse kritika negative e një pune është një sulm ndaj autorit apo një kritikë jo profesionale.

Parimi i pestë është **etika**. Protonistët nuk propagandojnë ndonjë etikë apo grup etike. Kur flasim për kritikën, atëherë protonisti punon për të observuar se si një kritik joprotonist i ka sistemuar, mbrojtur dhe rekoman-



Autori Gjekë Marinaj

duar konceptet e drejta dhe sjelljet e gabuara. E bëjnë këtë për të treguar anën e dobët të kritikëve, të cilët fokusohen vetëm tek anët e errëta të një vepre, duke mundësuar kështu privimin e lexuesve me një vizion dhe këndvështrim pozitiv, veçanërisht ata lexues të cilët nuk kanë një background kritik.

Për arsye vendi jemi të detyruar ta paraqesim fare shkurtimisht zhvillimin e këtyre parimeve në teorinë që ka përpunuar Dr. Marinaj. Në lidhjen e tyre, këto parime tregojnë qartë se Protonizmi si vizion letrar është diçka tjetër nga arti tradicional i kritikës letrare artistike, me gjithë pikat e përbashkëta që kanë. Dr. Marinaj e klasifikon Protonizmin si degë të arteve dhe humanizmit. Pra, jo patjetër degë të shkencës mbi letërsinë dhe artin. Dihet se kritika letrare e traditës sheh sipas rastit bardhë e zi, sheh ulje-ngritjet brenda veprës apo rrymave. Protonizmi, në kontrast, sheh bardhë, sheh lart.

Këtu duhet të shënojmë se si alternativë e re e trajtesave letrare, Protonizmi mund të japë përshtypjen se mund të jetë një koncesion ndaj të papërkryerës, se mund të jetë gjithashtu një aparat promovues i vlerave mesatare dhe të inkurajojë kështu kërkesa dhe ambicie mesatare. Por përkundrajt keqkuptimeve dhe keqinterpretimeve, Protonizmi propozohet si aparati pozitivist i profesionistit dhe jo i kujtdo.

Mendoj se Protonizmi është një teori shumë e dobishme, veçanërisht për nxitjen e shkrimtarëve dhe artistëve të rinj. Ata ndalojnë vetë nëse nuk kanë talentin dhe përgatitjen e duhur. Po kur i kanë dhuntinë, ata kanë nevojë pikërisht për protonizmin për t'u rritur në vetëbesim. Të afirmuarit gjithashtu kanë gjithnjë nevojë për gjykimin protonist. Fjala e mirë i bën me krahë të gjithë.

Lexuesit e librit “Protonizmi: Nga teoria në praktikë”, do të gjejnë në faqet e tij aplikimin e gjerë të kësaj teorie në një numër esesh, shënimesh dhe recensash letrare të autorit Gjekë Marinaj për shkrimtarë, poetë, piktorë, fotografë dhe muzikantë. Teoria e tij e re letrare, e para e këtij lloji nga një filolog shqiptar, po konsiderohet në katedrat dhe aulat më të njohura universitare-akademike të SHBA-së.



Njerëzit e lexim-shkrimit në Shqipëri kanë rastin të njihen me parimet bazë të kësaj teorie dhe me aplikime të saj nga vetë Dr. Gjekë Marinaj nëpërmjet librit të tij “Protonizmi: Nga teoria në praktikë”, botuar në shqip nga Shtëpia botuese “Nacional”. Qysh në hyrje të librit, Marinaj sqaron se si perceptim gjuhësor dhe si përshtatje terminologjike Protonizmi është bazuar në fjalën “proton”, një term nga Fizika dhe Kimia, që si pjesë përbërëse e bërthamës së atomit ka ngarkesë pozitive...